



# FTESË PËR KRYERJEN E KONTROLLIT MJEKËSOR BAZË PËR SHTETASIT 40-65 VJEÇ

RRETHI \_\_\_\_\_ QENDRA SHËNDETËSORE \_\_\_\_\_  
BASHKIA \_\_\_\_\_ ADRESA \_\_\_\_\_  
KOMUNA \_\_\_\_\_ NR. TELEFONI \_\_\_\_\_

**I nderuar Z/Zj \_\_\_\_\_**

**JU LUTEM  
PARAQITUNI ME KARTEN  
TUAJ TE IDENTITETIT**

Jeni i/e ftuar të paraqiteni pranë Qendrës Shëndetësore \_\_\_\_\_ në një nga datat e muajit të lindjes \_\_ / \_\_ / 201 \_\_; \_\_ / \_\_ / 201 \_\_; \_\_ / \_\_ / 201 \_\_ në orën \_\_\_\_\_, për të kryer procedurat e Kontrollit Mjekësor Bazë për moshat 40-65 vjeç. Përfshirë në këtë ftesë do të gjeni gjithashtu, një informacion rreth rëndësisë që ka ky test për shëndetin tuaj. Testi dhe procedura e marrjes së gjakut për analizë do të zgjasë rreth 30 minuta.

Ju lutemi të kontaktoni me personelin e Qendrës Shëndetësore ditën që do të paraqiteni për të kryer testin. Mjeku dhe infermieri do t'ju japin informacion më të zgjeruar dhe do t'ju ndihmojnë të kryeni kontrollin. Të gjitha mjetet e nevojshme për të marrë analizat e gjakut dhe urinës do të jenë të disponueshme në Qendrën Shëndetësore. Për të marrë rezultate sa më të sakta, ju duhet të paraqiteni në Qendren Shendetesore pa konsumuar ushqim për të pakten 9 deri 14 orë përpara marrjes së analizave. Gjithashtu keshillohet një dietë e pasur me fibra dhe mos konsumimi i Vitamines C, mishit, dhe nenprodukteve të tij deri në 3 dite para kontrollit.

Mjeku i Familjes pranë Qendrës suaj Shëndetësore do t'ju informojë rreth kontrollit periodik dhe për rezultatet e analizave të ardhura nga laboratorit Klinik-Biokimik. Shpresojmë që t'i kushtoni rëndësinë e duhur kryerjes së kontrollit dhe të paraqiteni në kohën e caktuar.

E gjithë paketa e Kontrollit Mjekësor Bazë përfitohet pa pagesë, pavarësisht nëse keni apo jo siguracion shëndetësor. Nëse nuk keni mundësi të paraqiteni në datën dhe orën e caktuar, ju lutemi, me të marrë këtë njoftim, kontaktoni paraprakisht me Infermierin e Familjes ose kabinetin e Kontrollit Periodik në Qendrën Shëndetësore, të cilëve mund t'u kërkonit një datë më të përshtatëshme për të kryer procedurat.

Vini re! Kontrolli Mjekësor Bazë për shtetasit 40-65 vjeç është një kontroll mjekësor depistues, i cili shërben për të kapur sinjalet e para, të fshehta apo të dukshme, të çrregullimeve të shëndetit tuaj. Për të vendosur diagnozën dhe trajtimin, në rast se kapen sinjalet, do të duhen konsulta të mëtejshme dhe në varësi të konsultës, ekzaminime e analiza të tjera. Mjeku juaj në Qendrën Shëndetësore do t'ju informojë dhe orientojë nëse thjesht duhet të ktheheni pas një viti për kontrollin bazë të radhës apo të caktoni një orar për një konsultë mjekësore për diagnostikim dhe planifikim trajtimi sipas shenjave apo shqetësimeve që ju paraqisni.

Me respekt, Dr. \_\_\_\_\_

Drejtori i Qendrës Shëndetësore

Firma, Vula e Drejtorit ose MPF dhe e QSH

Data: \_\_\_\_\_



# DOKUMENT INFERMIEROR: INFORMACION PËR PËRFITUESIN E PAKETËS

## Çfarë është kontrolli mjekësor bazë dhe përse ju shërben?

Çdo individ, sado i shëndetshëm, në një etapë të caktuar të jetës së tij (që nga mosha mesatare), është i rrezikuar nga sëmundjet si ato të zemrës dhe enëve të gjakut, goditjet ne tru, diabeti, sëmundjet e veshkave, disa forma të demencës, depresioni etj. Shfaqjen e këtyre sëmundjeve mund ta favorizojnë gjithashtu edhe disa faktorë që lidhen me mënyrën e jetesës, stresin, trashëgueshmërinë familjare etj. Kontrolli nëpërmjet paketës së detyrueshme për moshat 40-65 vjeç, ka si qëllim të ulë rrezikun për të zhvilluar këto sëmundje të rrezikshme, por të parandalueshme. Personeli infermier që do të ofrojë shërbimin e Paketës së Detyrueshme të Kontrollit Mjekësor për moshën 40-65 vjeç, është profesionalisht i aftë dhe i trajnuar për të gjithë elementët shërbimit. Rreziku për sëmundje do të vlerësohet nëpërmjet disa testeve të thjeshta dhe pyetjeve standart për stilin e jetës që bëni, mënyrën e ushqyerjes, dhe historinë mjekësore të familjes suaj. Është e këshilueshme për të gjithë personat që mund të përfitojnë, të mos e humbasin mundësinë për të kontrolluar gjëndjen e tyre shëndetësore, të paraqiten në kohën e caktuar për të marrë shërbimin që ofron Qendra Shëndetësore me anë të këtij kontrolli rutinë të përvitshëm. Kjo do të thotë që të jeni të vëmendshëm dhe të veproni herët, për të përmirësuar ndjeshëm dhe në kohë shëndetin, për të gëzuar një jetë më të mirë dhe më të gjatë. Ndryshime të vogla, të vazhdueshme të mënyrës së jetesës, mund të bëjnë diferencë të madhe ndërmjet të sëmurit dhe të shëndetshmit. Nëse keni shqetësime që lidhen me shëndetin, mos prisni të vijë koha e përfitimit të Paketës së kontrollit mjekësor bazë, por drejtohuni pranë qendrës shëndetësore dhe kontaktoni me infermierin dhe mjekun e familjes.

## Çfarë ndodh gjatë kryerjes së Kontrollit Mjekësor Bazë?

Infermieri do t'ju informojë mbi të gjithë testimin që do të kryeni. Ju do ti përgjigjeni disa pyetjeve të thjeshta që do t'ju drejtojë infermierja dhe do të kryeni disa kontrole të zakonshme të cilat nuk ju shkaktojnë dhimbje dhe nuk kërkojnë mundim. Kontrolli do të zgjasë rreth 30 minuta.

Do t'i përgjigjeni pyetjeve të thjeshta rreth historikut shëndetësor të familjes suaj, nëse pini duhan ose ç'sasi alkooli konsumoni në ditë.

Infermierja do t'ju masë gjatësinë dhe peshën trupore.

Do të shënohet mosha, gjinia, profesioni që ushtroni, kombësia etj.

Do të bëhet matja e Tensionit Arterial.

Do të merret gjak venoz me metodë jo të dhimbshme, për të bërë analizat klinike e biokimike në laboratorët e caktuar.

Do të merren mostrat e urinës dhe feçeve për të kryer analizat përkatëse.

Ju do të merrni këshilla të vlefshme mbi gjithçka që u përmend lidhur me shëndetin. Me të dalë përgjigjet e analizave që keni kryer, ato do të dërgohen tek mjeku juaj i familjes dhe ju do të njoftoheni nga mjeku mbi rezultatet e analizave dhe domethenien e tyre. Do të keni mundësinë të kërkonti udhëzime dhe mbështetjen e stafit mjekësor lidhur me ruajtjen e shëndetit, këshilla për ndryshime të mënyrës së jetesës, që do t'ju ndihmojnë për të përmirësuar shëndetin. Nëse është e nevojshme, mjeku do t'ju ofrojë mundësinë të trajtoheni me mjekime, do t'ju rekomandojë kontrole të mëtejshme tek mjekët specialistë, egzaminime të nivelit të dytë etj. Mund të kërkonti gjithashtu mbështetjen e stafit mjekësor për të lënë duhanin, alkoolin, për të përmirësuar aktivitetin fizik, ushqyerjen etj. Ju do të informoheni gjithashtu lidhur me kontrollin e ardhshëm.

## Metoda e mbledhjes së kampionit të feces

Kampioni i feces duhet të merret nga pacienti në shtëpi, i cili më pas do ta marrë me vete në datën e caktuar për vizitën në qendrën shëndetësore. Kampioni i feces mund të mbledhet direkt nga tualeti përmes një letre tualeti apo konteneri të pastër. Me anë të lugëzës të shishes që ndodhet në zarf merr mostër nga rreth 5 vënde të ndryshme të jashtëqitjes. Mbyll kapakun me lugëzën brenda dhe paraqitni shishen në Qendrën Shëndetësore.